



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2025

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Varianti A

10 qershor 2025

Gjuhë shqipe dhe letërsi (Gjimnazi dhe gjimnazi gjuhësor)

Shënim: Vlerësuesit e testeve janë trajnuar, që të vlerësojnë çdo përpjekje të nxënësit dhe të jenë të kujdesshëm, sidomos në pyetjet e hapura, të cilat kanë më shumë mundësi përgjigjeje dhe ku nxënësit shprehen shpesh dhe me përgjigje të përafërta.

Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit

PJESA I

Mund t'ia dilni

Pyetja 1	B	1 pikë
Pyetja 2	C	1 pikë
Pyetja 3	C	1 pikë
Pyetja 4	A	1 pikë
Pyetja 5	D	1 pikë
Pyetja 6	B	1 pikë
Pyetja 7	C	1 pikë
Pyetja 8	D	1 pikë
Pyetja 9	A	1 pikë
Pyetja 10	B	1 pikë

Pyetja 11**2 pikë****Përgjigje e plotë:****Gjymtyrët homogjene:** ulje dhe ngritje, turbulenca dhe paqe, suksese dhe vuajtje.**Klasa e fjalëve:** shprehur me emra.**OSE****Gjymtyrët homogjene:** i pasur dhe i varfër; i aftë dhe i paaftë fizikisht.**Klasa e fjalëve:** shprehur me mbiemra.**2 pikë** Nëse nxënësi gjen gjymtyrët homogjene dhe tregon klasën e fjalëve së cilës i përkasin.**1 pikë** Nëse nxënësi identifikon gjymtyrët homogjene.**1 pikë** Nëse nxënësi përcakton klasën e fjalëve.**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.**Pyetja 12****3 pikë****Model përgjigjeje:****Mund të identifikojë dy nga këto pyetje:**

- Si do të ushqejmë popullsinë botërore që po rritet?
- Si do të ofrojmë ujë të pastër?
- Si do të prodhojmë energji të rinovueshme?
- Si do të parandalojmë dhe kurojmë sëmundjet?
- Si do të ngadalësojmë ndryshimet globale klimatike?

Arsyeja e përdorimit të teknikës:

Këto pyetje nxisin një ndjenjë përgjegjësie për brezat e ardhshëm, për t'i bërë ata të mendojnë dhe të punojnë për zgjidhje afatgjata që do të sigurojnë një të ardhme më të mirë dhe më të qëndrueshme për të gjithë.

OSE

Teknika e pyetjeve tërheq vëmendjen e lexuesve, i përfshin emocionalisht, i nxit të bëhen të vetëdijshëm për problemet e të sotmes dhe të së ardhmes.

2 pikë Nëse nxënësi gjen dy pyetje.**1 pikë** Nëse nxënësi gjen një pyetje.**1 pikë** Nëse nxënësi shpjegon arsyen e përdorimit të kësaj teknike.**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 13**2 pikë****Përgjigje e saktë:****E gabuar:** Teoria e gjithçkaje**E saktë:** "Teoria e gjithçkaje"**E gabuar:** qëllimi jonë**E saktë:** qëllimi ynë**2 pikë** Nëse nxënësi gjen dy gabimet dhe i korrigjon ato.**1 pikë** Nëse nxënësi gjen një gabim dhe e korrigjon atë.**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.**Pyetja 14****3 pikë****Model përgjigjeje:**

- a) Autori është i lumtur, i kënaqur, entuziast, i plotësuar, i duket se ka kaluar një jetë të jashtëzakonshme, e cila ka përfshirë udhëtime në galaktikë, përjetime ekstreme dhe arritje shkencore. Është ndier i vlerësuar dhe i rrethuar nga dashuria e njerëzve të tij.

Ilustrimi: Kam kaluar një jetë të jashtëzakonshme, ndihem i lumtur për të ndarë me lexuesin entuziazmin tim etj.

- b) Qëllimi i tekstit është që të nxitë një frymë optimizmi dhe besimi në mundësitë e shkencës dhe të bashkëpunimit për të arritur qëllime të mëdha.

Kjo ndjesi e ndihmon atë të tregojë entuziazmin e tij për këto pyetje dhe arritje. Ai i inkurajon, i motivon lexuesit të jenë kureshtarë dhe të vendosur në kërkimin e së vërtetës, edhe kur përballen me vështirësi.

1 pikë Nëse nxënësi gjen ndjesinë e autorit.**1 pikë** Nëse nxënësi gjen një ilustrim mbi këtë ndjesi.**1 pikë** Nëse nxënësi shpjegon lidhjen e ndjesisë me qëllimin e tekstit.**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 15**3 pikë****Përgjigje e plotë:****Figura stilistike:** metaforë ose epitet metaforik; universi do të ishte i zbrazët.**Interpretimi:** Kjo metaforë krijon një përfytyrim më të gjallë dhe konkret të rëndësisë së dashurisë dhe lidhjeve njerëzore, pa të cilat arritjet shkencore dhe përvojat do të ishin të pafuqishme për t'i dhënë kuptim jetës.

Ky përdorim i metaforës nxit lexuesin të mendojë më thellë për domethënien e jetës, vlerën e dashurisë dhe rëndësinë e frymës së bashkëpunimit mes njerëzve.

Përgjigje e pjesshme:**Interpretimi:** kjo metaforë krijon një përfytyrim më të gjallë të rëndësisë së dashurisë.

Ky përdorim i metaforës e bën lexuesin të mendojë për rëndësinë e dashurisë.

1 pikë Nëse nxënësi gjen figurën letrare.**2 pikë** Nëse nxënësi interpreton funksionin e figurës letrare.**1 pikë** Nëse nxënësi interpreton pjesërisht funksionin e figurës letrare.**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare*Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.***Pyetja 16****3pikë****Model përgjigjeje:****Karakteristikat:**

- folja në mënyrën urdhërore: *tregohuni*;
- folja në mënyrën lidhore: *të favorizojnë*;
- folja modale: *mund*;
- *fjali nxitëse*;
- veta e dytë shumës.

Shpjegimi: Veta e dytë dhe folja në mënyrën urdhërore thekson tonin inkurajues dhe motivues të tekstit. Autori synon të nxitë, të inkurajojë njerëzit të përballojnë sfidat, t'u japë besim të ecin përpara dhe të kontribuojnë në një të ardhme më të mirë.**2 pikë** Nëse nxënësi gjen dy karakteristika.**1 pikë** Nëse nxënësi gjen vetëm një karakteristikë.**1 pikë** Nëse nxënësi shpjegon funksionin e tyre lidhur me qëllimin e tekstit.**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

PJESA II**Jeronim de Rada****Këngët e Milosaos (Kënga XIII)**

Pyetja 17	B	1 pikë
Pyetja 18	A	1 pikë
Pyetja 19	C	1 pikë
Pyetja 20	A	1 pikë
Pyetja 21	B	1 pikë
Pyetja 22	B	1 pikë
Pyetja 23	D	1 pikë
Pyetja 24	C	1 pikë
Pyetja 25	A	1 pikë
Pyetja 26	A	1 pikë

Pyetja 27 3 pikë

Model përgjigjeje:

Ndikimi: Në përputhje me parimet e romantizmit, natyrës i është dhënë një rol simbolik dhe emocional në poezi. Ajo përdoret për të krijuar një atmosferë të ngrohtë dhe shpresëdhënëse. Elementet e natyrës përforcojnë ndjenjën e paqes dhe begatisë së munguar në kohë lufte, krijojnë imazhin e lirisë që dëshiron të përcjellë poeti. Këto detaje i kujtojnë Milosaos detyrën ndaj atdheut duke i zgjuar mallin për viset që po lë pas dhe i shtojnë përgjegjësinë për idealin e së ardhmes.

Japin simbolikën e paqes dhe elemente mesdhetare.

Ilustrimet: “dimër i butë”, “era e lehtë”, “ullinj”, “qumësht”.

Përgjigje e pjesshme:

Atmosfera është e ngrohtë ose elementet e natyrës janë shpresëdhënëse, ose i kujton Milosaos detyrën ndaj atdheut duke i zgjuar mallin për viset që po lë pas.

3 pikë Nëse nxënësi shpjegon ndikimin e elementeve të natyrës dhe ilustron me një shembull.

2 pikë Nëse nxënësi shpjegon ndikimin e elementeve të natyrës në krijimin e atmosferës.

1 pikë Nëse nxënësi shpjegon në mënyrë të pjesshme ndikimin e elementeve të natyrës në krijimin e atmosferës.

1 pikë Nëse nxënësi gjen një ilustrim.

0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 28**2 pikë****Model përgjigjeje:****Tiparet folklorike:**

- Përdorimi i vargut tetërrokësh i bardhë.
- Gjuha e përdorur (urimet).
- Traditat dhe zakonet (vallja ,dasma).
- Simbolet e qëndresës dhe begatisë (ulliri, qumështi).

2 pikë Nëse nxënësi gjen dy tipare.**1 pikë** Nëse nxënësi gjen vetëm një tipar.**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 29**3 pikë****Përgjigje e plotë:**

Interpretimi: Figura e nënës në këtë këngë jepet plot dashuri dhe dhembshuri. Ajo është krenare që po e përcjell djalë në luftë dhe i uron kthim me fitore. Ajo shfaqet shpresëdhënëse, besimplotë, e devotshme duke shfaqur mëmësinë. Si të gjitha gratë shqiptare ajo do të kujdeset për rritjen e fëmijëve dhe vazhdimësinë e jetës, për familjen, ndërkohë që djemtë janë në luftë. Ajo përcjell idenë e qëndresës, sakrificës së nënave për lirinë e atdheut.

Ilustrimi: edhe unë i vihem punës,/ që të rrit fëmijët**OSE**

martesa e bijave

Përgjigje e pjesshme:**Interpretimi:** Nëna është krenare që po e përcjell djalë në luftë dhe i uron kthim me fitore.**OSE**

Si të gjitha gratë shqiptare ajo do të kujdeset për rritjen e fëmijëve dhe vazhdimësinë e jetës.

OSE

Ajo përcjell idenë e qëndresës, sakrificës së nënave për lirinë e atdheut.

2 pikë Nëse nxënësi bën interpretimin e plotë.**1 pikë** Nëse nxënësi bën një interpretim të pjesshëm.**1 pikë** Nëse nxënësi shkruan ilustrimin përkatës.**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 30**3 pikë****Model përgjigjeje:**

Raporti kuptimor: Në këto dy urime krijohet raport kundërshtie kontekstuale, antonimi kontekstuale ose antitezë kontekstuale mes largimit dhe rikthimit.

Fjalët që krijojnë këtë raport: Janë foljet *vafsh* dhe *sjellsh*.

Interpretimi: Thekson shpresën dhe besimin e nënës se Milosao do të kthehet bashkë me lirinë. Ajo vlerëson mbi gjithçka detyrën ndaj atdheut, por si çdo nënë ajo uron që Milosao të kthehet shëndoshë e mirë.

3 pikë Nëse nxënësi gjen raportin kuptimor, dallon fjalët që e krijojnë atë dhe bën interpretimin e tij.

1 pikë Nëse nxënësi gjen raportin kuptimor.

1 pikë Nëse nxënësi identifikon fjalët (foljet).

1 pikë Nëse nxënësi bën interpretimin e kontrastit.

0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 31**2 pikë****Model përgjigjeje:**

Ideja: Vetëm nëpërmjet luftës dhe sakrificave mund të fitohet liria e humbur.

OSE

Pa lumturinë e atdheut, nuk ka lumturi personale.

Tipari: Krijohet përfytyrimi i heroit romantik që është i gatshëm të luftojë dhe sakrifikojë për idealin kombëtar, që të sjellë lirinë dhe një jetë më të mirë e të begatë.

2 pikë Nëse nxënësi zbulon idenë dhe tiparin kryesor të heroit romantik .

1 pikë Nëse nxënësi zbulon idenë.

1 pikë Nëse nxënësi zbulon tiparin kryesor të heroit romantik.

0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 32**3 pikë****Model përgjigjeje:**

Ideali i së ardhmes, është liria dhe paqja e atdheut. Vetëm në liri mund të vazhdojë jeta dhe të lindë shpresa për të ardhmen dhe begatinë.

Detajet që mund të përdorë: dasmat që do të bëhen, ullinjë, qumështi, agimi dhe Shenjëza që i gëzon zemrën, kujdesi për fëmijët që do të lindin dhe do të sigurojnë vazhdimësinë e jetës.

3 pikë Nëse nxënësi bën një përshkrim të plotë me detaje nga fragmenti, përdor gjuhë përshkruese dhe leksik të zgjedhur.

2 pikë Nëse nxënësi bën një përshkrim të pjesshëm pa përdorur detajet.

1 pikë Nëse nxënësi identifikon idealin e së ardhmes në liri.

0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

PJESA III**Pyetja 33****8 pikë**

Për pjesën ese do të ndiqen në vlerësim kriteret e mëposhtme:

Shtjellimi i idesë**2 pikë**

- shkruan një ese, e cila mbështetet në thënien e S.Houking, ose në mesazhin e fragmentit joletrar, ose në çdo përvojë personale të nxënësit;
- shtjellon përjetime nga ngjarje të cilat kanë ndikuar në jetën e tij;
- shtjellon ngjarje që i kanë ndryshuar këndvështrimin për botën;
- sjell përfytyrime në formën e historive të krijuara;
- zbërthen bërthamën e temës së dhënë .

Organizimi dhe struktura**2 pikë**

- përdor strukturë të qartë eseje: hyrje – zhvillim – mbyllje;
- siguron kalimin rrjedhshëm në paragrafët zhvillues;
- grupon çështjet në paragrafë të organizuar drejt, qartë, saktë dhe në mënyrë të plotë e të logjikshme;
- zgjedh dhe përdor konektorët e duhur për të siguruar koherencën dhe kohezionin e tekstit. Këta janë të shumëllojshëm dhe i shmangen fjalorit të gjuhës së përditshme;
- përcjell konkluzionin personal në raport me temën (paragrafi përmbyllës).

Stili dhe origjinaliteti**2 pikë**

- përdor një gjuhë të qartë dhe origjinale, për krijimin e një përshtypjeje të plotë për atë që shprehet në raport me temën;
- përdor një gjuhë të pasur me detaje të shumta që mbështetin idenë dhe që ndikojnë dhe vënë në lëvizje imagjinatën e lexuesit;
- përdor gjuhë subjektive dhe shpesh format shpjeguese gërshetohen me detaje përshkruese;
- përdor fjalor të pasur dhe të shumëllojshëm, me shprehje të zgjedhura që sigurojnë origjinalitet në shkrim dhe dëshmojnë për një formim të mirë jo vetëm letrar, por edhe gjuhësor.

Saktësia gjuhësore**2 pikë**

- përdor drejt struktura të fjalive, të cilat mbështetin nga pikëpamja gjuhësore përmbajtjen e esesë;
- shkruan pa gabime fjalë të përdorimeve të shpeshta (ose jo), si dhe ndërton drejt, sipas kuptimit apo kumtimit, të gjitha llojet e fjalive;
- përdor saktë shenjat e pikësimit, të të gjitha llojeve: pikë, presje, dy pika, pikëçuditëse, pikëpyetje, vizë ndarëse etj., gjë që dëshmon për njohje shumë të mirë të rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- shkruan saktë nga pikëpamja e drejtshkrimit, sintaksës e pikësimit, gjë që mbështet në mënyrë të plotë strukturën e fjalive.

Shënim: Në vlerësimin e esesë, rubrikat që do të vlerësohen nuk mund të shihen të palidhura me njëra-tjetrën, pasi ato nuk mund të kenë një mëvetësi të plotë, ato shihen në harmoni. Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë çdo përpjekje të nxënësit.